



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
4 PRILL 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
4. APRIL 2008. GODINE

Prill – April
2008

R e n d i i d i t ë s:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 28 marsit 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë private,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, dhe
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve.

D n e v n i r e d:

1. Usvajanje zapisnika sa plenarne sednice od 28. mara 2008,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Prvo razmatranje N/zakona o pečatima u institucijama Republike Kosova,
4. Prvo razmatranje N/zakona o privatnoj sigurnosti,
5. Drugo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Privremenog krivičnog zakonika Kosova,
6. Drugo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona o zadrugama poljoprivrednika.

A g e n d a:

1. Approval of the minutes from the plenary session of 28 March 2008,
2. Time for parliamentary questions,
3. First reading of the Draft Law on Stamps of the Republic of Kosovo Institutions,
4. First reading of the Draft Law on Private Security,
5. Second reading of the Draft Law on Supplementation and Amendment of the Kosovo Provisional Criminal Code,
6. Second reading of the Draft Law on Supplementation and Amendment of the law on Farmer's Cooperatives.

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 4 PRILL 2008

Seanca filloi në orën 10,00

Seancën e drejtoi, zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar – mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Para se t'ia fillojmë punës, shfrytëzoj rastin që në emrin tuaj, në emër të Kuvendit të Kosovës, në emër të qytetarëve të Kosovës, ta përshëndesim vendimin e Gjykatës së Hagës për lirim të ish-kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, nga vepra e ngarkuar.

(Duartrokitje)

Shfrytëzoj rastin ta përshëndes Republikën e Shqipërisë dhe atë të Kroacisë për marrjen e ftesës për t'u integruar në NATO.

(Duartrokitje)

Tani ia fillojmë punës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 95 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, Kryesia ka përgatitur dhe Kuvendit ia paraqet rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ju njoftoj, gjithashtu, se rendi i ditës së bashku me materialin u është shpërndarë deputetëve.

Andaj, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Para se të kalojmë në rend të ditës nuk kërkohet që këtë që do ta them ta vini në rend të ditës, normalisht, sepse dihen procedurat.

Më lejoni t'ju përshëndes juve dhe Qeverinë. Kolegët deputetë, sigurisht edhe unë, e thatë në emrin tonë, i bashkëngjitëm gëzimit për vendimin e lirimit të ish-kryeministrit, zotit Haradinaj. Unë në emër, jo të gjithëve, por të shumicës, sepse me të gjithë s'kemi kontaktuar, dëshiroj ta them një çështje, përkatësisht ta ngritë një problem rreth punës dhe funksionimit të komisioneve.

Unë i di procedurat, kemi pasur një takim me ju, por këtu do ta ngrit në mënyrë që, vërtet, kërkesat tona, të shumicës dërmuese, janë këto.

Të furnizohemi rregullisht me materialet e nevojshme dhe elementare për furnizim të zyrave dhe komisioneve tona, sepse kemi shumë mungesa. Të na sigurohet si komision për funksionim normal, më fal unë po e ngrit, sepse fundin kur ta merrni e dini se ka arsyetim.

KRYETARI: Ju lutem, këto procedura dihen, duhet të bëhen me shkrim dhe pastaj të ...

ISMET BEQIRI: Me shkrim e kam bërë, zoti Kryetar.

KRYETARI: Ju lutem, unë e respektoj, por je deputet i ri, sesi ngritën këto çështje me shkrim së pari, ju e dini se ne si Kuvend as si administratë e Kuvendit, as si deputet, as si Kryesi, as si kryetar, nuk menaxhojmë fjalë, menaxhojmë letra. Letrat vijnë në rrugë administrative dhe dihet, e keni Rregulloren, lexoni Rregulloren dhe mbi bazën e Rregullores, shfrytëzoni të gjitha kërkesat dhe të drejtat tuaja.

ISMET BEQIRI: Dakord, Kryetar edhe këto rregullore s'jeni kah i respektoni, prandaj unë desha ta përfundoj.

KRYETARI: Unë ta them lexoni Rregulloren,

ISMET BEQIRI: I kam lexuar.

KRYETARI: Unë jam duke respektuar Rregulloren. Kur të merret vendim të ndryshohet Rregullorja, përsëri punojmë me Rregulloren e ndryshuar. Ne jemi duke punuar me Rregullore, lexoni Rregulloren.

ISMET BEQIRI: Mirë, unë do ta shfrytëzoj të drejtën të pyetjet parlamentare kur të vjen, nëse jo sot, tjetër ditë.

KRYETARI: Mund ta shfrytëzosh të drejtën edhe me shkrim.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 28 mars 2008

I keni marrë procesverbalin dhe transkriptin. Kush ka vërejtje në procesverbal edhe në transkript?

Konstatohet që nuk ka, domethënë, miratohet procesverbali nga seanca e 28 marsit 2008.

Pika e dytë e rendit të ditës-

Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se, në pajtim me rregullën 26.1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Në afatin e përcaktuar me Rregullore, janë parashtruar 12 pyetje parlamentare, të cilat do të procedohen sipas radhës.

Pyetja e parë është parashtruar nga deputeti Bahri Hyseni, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.

Lus deputetin Bahri Hyseni, ta lexojë pyetjen.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Përshëndetje, i nderuar, zoti Kryeministër,
Zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra dhe
Kolegë deputetë.

Duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, ngrit këtë çështje.
Në ditën e madhe të 17 shkurtit, Kosova shpalli pavarësinë e saj. Pas kësaj dite kemi pasur njohje të pavarësisë nga shumë shtete të rëndësishme të demokracisë perëndimore. Zoti Kryeministër, pyetja ime është - A është i kënaqshëm niveli i njohjes së këtyre shteteve, sa shtete kanë njohur deri më tani Republikën e Kosovës, sa shtete priten ta njohin dhe çfarë keni ndërmarrë që edhe shtetet fqinje të bëjnë njohjen e shtetit të Kosovës?
Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Kryeministër e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar deputetë, ministra.

I nderuar, zoti deputet. Njohja e pavarësisë së Kosovës nga bota demokratike është e impresionuar e fuqishme dhe historike.

Deri më tani Republikën e Kosovës e kanë njohur 38 shtete me më ndikim në botë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Japonia, Kanadaja dhe shumica dërmuese e shteteve të Bashkimit Evropian dhe vendet e tjera që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian.

Bashkimi Evropian është unik në mbështetje të pavarësisë së Kosovës. Kosova, pas Forumit në Bërdo të Sllovenisë, ku u përfaqësua nga Qeveria e pavarësisë së Kosovës dhe Samitit të NATO-së në Bukuresht, që u zhvillua, është kandidatë de fakto për fillimin e procesit të anëtarësimit në NATO dhe në Bashkimin Evropian.

Njohja e pavarësisë së Kosovës është rast unik në historinë e formimit të shteteve të reja në botë, në 30-vjetshin e fundit. Kjo e arritur në bazë të punës së përbashkët, orientimit properëndimor, qeverisjes së mirë, lobimit efektiv dhe unitetit politik dhe qytetar të vendit, është e arritur e përbashkët.

Në emër të institucioneve të Kosovës, falënderoj të gjitha shtetet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe ftoj edhe vendet e tjera të bëjnë të njëjtën gjë.

Sa i përket vendeve fqinje, ju e dini: Shqipëria e ka njohur pavarësinë e Kosovës, Maqedonia veç e ka marrë vendimin, pritet ta bëjë publik së shpejti njohjen e pavarësisë së Kosovës. Mali i Zi e ka përkrahur vendimin e Bashkimit Evropian dhe duhet të jetë pjesë e komunitetit ndërkombëtar për njohje të pavarësisë, ndërsa, duam, besojmë se edhe në Serbi, pas zgjedhjeve të 11 majit do të fillojnë të mendojnë seriozisht për njohjen e pavarësisë së Kosovës.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

A keni pyetje shtesë, deputet? Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti deputet Hyseni!

Mendoj se e njëjta përgjigje është, ka qenë, përafërsisht, e njëjta pyetje edhe nga zoti Ibrahim Gashi, por, sido që të jetë, këtu jemi.

KRYETARI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë?

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Nuk ka pyetje shtesë? Faleminderit për përgjigje!

KRYETARI: Nuk ka, mirë, faleminderit!

Kalojmë në pyetjen e dytë.

Deputeti Driton Tali – AKR- pyetje për Kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi. Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

E nderuara Qeveri.

Edhe unë do t'i bashkëngjitëm urimit, por edhe keqardhjes për familjen e Lahi Brahimaj dhe zotit Lahi Brahimaj.

Zoti Kryetar, duke pasur parasysh disa prononcime të Ministrisë së Energjetikës dhe të Minierave dhe të Qeverisë, lidhur me projektin për ndërtimin e Termocentralit Kosova

C 2100 megavat, të cituara në media dhe deklaratën e djeshme, në opinion është krijuar mjegullnajë. Pyetja është - Cili është qëndrimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me projektin për ndërtimin e Termocentralit Kosova C 2100 megavat? A është Qeveria për apo kundër ndërtimit të Termocentralit Kosova C me kapacitet 2100 megavat?

KRYETARI: Fjalën e ka Kryeministri!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari, zoti deputet Tali.

Ju e dini, Qeveria aktuale gjendjen në Korporatën Energjetike të Kosovës e ka gjetur në kolaps të vërtetë, por kemi filluar menjëherë përkushtimet tona për përpunimin e strategjisë për nxjerrje të Kosovës nga terri në dritë. Natyrisht, gjatë kësaj periudhe kemi hasur në vështirësi të shumta, por vështirësitë e grumbulluara në të 8 vjetët e kaluara gradualisht po i tejkalojmë. Pra, kemi zhvilluar konsulta të vazhdueshme dhe rekomandime, të cilat kanë ardhur nga Ministria e Energjetikës, pastaj me këshilltarët dhe rekomandimet shumë produktive që kanë qenë edhe nga ekspertët e Bankës Botërore të USAID-it, pastaj të njerëzve profesionistë në KEK. Kemi diskutuar edhe me njerëzit ambientalist në Kosovë, sindikatat, por falënderoj dhe shpreh konsideratë edhe për mbështetje nga opozita demokratike për projektet që ka prezantuar apo idenë dhe vizionin që ka prezantuar Qeveria e Kosovës se ky proces duhet të kalojë definitivisht nga ekonomia e planifikuar në ekonomi të lirë të tregut, në proces koncesioni, privatizimi dhe më tutje të vazhdohet me zhvillimin e kujdesshëm të procesit të projektit të Kosovës C. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Deputet Tali, a ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Po, zoti Kryetar!

Pyetja është kjo- Duke pasur parasysh se qëndrimi i Qeverisë një hije ka qenë për Termocentralin e ri të jetë 500 deri, jo më shumë 700 megavat dhe pjesa tjetër e energjisë të përfitohet nga energjia e ashtuquajtur e ripërtërirë.,

Siç po shihet, këtu nuk duhet të jesh epistomolog për ta kuptuar se Qeveria ka ndryshuar qëndrimin ndaj projektit të qasjes së mëparshme.

Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, a keni përgjigje ?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti deputet Tali, me respektin më të lartë, Qeveria nuk e ka ndryshuar qëndrimin, por e ka zhvilluar qëndrimin.

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetja e tretë është e deputetes Gjylnaze Sylja – AAK- për Kryeministrin Hashim Thaçi.

GJYLNAZE SYLA: Sipas rregullës 18.2 të Rregullores, Qeveria është dashur 2 javë pas zgjedhjes së saj t'ia paraqesë programin Kuvendit të Kosovës. Është shqetësuese që gati 3 muaj kanë kaluar dhe ne ende s'e kemi programin, shqetësuese është se nuk ka vizion, zoti, Kryeministër. Prandaj pyetja ime është- Pse Qeveria nuk ka program?

KRYETARI: Zoti Kryeministër e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete, Gjylnaze Sylja.

Ju e dini se Qeveria e Kosovës në ditën kur është formuar ka qenë periudha e Kornizës Kushtetuese dhe, gjithashtu, ju e dini si deputete e vjetër dhe veprimtare e vjetër se nga ana ime nuk ka qenë shumë e pëlqyeshme Korniza Kushtetuese, por përkushtimi im ka qenë që Kosova të ketë Kushtetutë.

E nderuara deputete, në ditën e zgjedhjes së Qeverisë nga ky Parlament kam paraqitur një ekspozë substanciale për programin qeveritar në atë kohë, duke e ditur që shumë shpejt Kosova do të pavarësohej dhe do të njihej nga bota demokratike. Në përputhje me këtë, kam pasur përkushtimin që t'i bëjmë edhe synimet tona si Qeveri e shtetit të pavarur, sovran dhe demokratik të Kosovës.

Arsyeja e dytë, është se në atë kohë kemi funksionuar në mungesë të dokumentit kushtetues të Republikës së Kosovës, e cila institucioneve të Kosovës u jep tani kompetenca të plota si një shtet sovran dhe i pavarur dhe në përputhje me këtë do t'i bëjmë të gjitha prioritetet dhe realizimet e tyre.

Një arsye tjetër e veçantë është Konferenca e Donatorëve që pritet të mbahet në muajin qershor. Ne kemi punuar në harmonizimin e prioritetëve tona me ato të donatorëve potencial për mbështetje dhe tani mund të them lirisht se i kemi arritur të tri qëllimet.

Në mbledhjen e fundit të Qeverisë, përkatësisht dje, kemi miratuar programin dhe që nga e hëna do ta sjellim në Kuvend.

Ju ftoj që ta debatojmë, t'i jepni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja dhe të bëjmë një program që shpreh aspiratat e institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës për zhvillimin tonë të gjithmbarshëm të vendit.

Mendoj se është një pyetje e njëjtë edhe nga e nderuara deputete Suzan Novobrdaliu, prandaj mendoj se do të jetë përgjigje e njëjtë edhe për ju e nderuara Suzana. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër! A keni pyetje shtesë deputete? Deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Zoti Kryeministër.

Korniza Kushtetuese për të cilën ju thoni se keni qenë kundër, nuk ju ka penguar të zgjidheni kryeministër. Nuk ju ka penguar, gjithashtu, që t'ia zgjatni mandatin vetës

katër vjet. A nuk ndjeheni të përgjegjshëm para qytetarëve të Kosovës, me qenë se keni deklaruar vazhdimisht se do të jeni transparent dhe të përgjegjshëm?

KRYETARI: Faleminderit!
Kryeministër, a keni përgjigje?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Natyrisht se ndihem shumë mirë dhe shumë krenar bashkë me ju që Kosova tanimë e ka Kushtetutën e vet, në ditët e ardhshme edhe Parlamenti do ta miratojë. Ndihem shumë mirë dhe shumë krenar bashkë me ju që Kosova është shtet i pavarur, sovran dhe demokratik dhe punojmë si shtet dhe kandidat de fakto për NATO dhe Bashkim Evropian. Faleminderit, besoj se ndihesh krenar.

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër, faleminderit deputete!
Kalojmë në pyetjen e katërt.

Deputeti Ibrahim Gashi - AKR. Pyetje për Kryeministrin Thaçi apo zëvendëskryeministrin, edhe pse në pyetjen e parë Kryeministri ia dha edhe një përgjigje deputetit Gashi.

Deputeti Gashi, mund ta lexoni pyetjen.
E ka fjalën deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!
Përshëndetje për zotin Kryeministër,
Zëvendëskryeministrin dhe ministrat,
Të nderuar kolegë deputetë.

Pyetja ime është përafërsisht e ngjashme me atë të kolegut Hyseni, mirëpo ndryshon në disa nuanca të vogla. Po dëshmohet se funksionalizimi i Ministrisë së Jashtme të Republikës së Kosovës po shkon me ritëm të ngadalshëm. Në këto rrethana të mosfunksionalizimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, cilat janë veprimet konkrete në Qeverinë e Kosovës në drejtim të lobimit në shtetet që refuzojnë apo hezitojnë ta njohin pavarësinë e Kosovës? Sa po shfrytëzohet ajo që njihet si diplomaci publike ose diplomaci parlamentare për t'i hapur rrugë diplomacisë oficiele te vendet që hezitojnë ta njohin Kosovën? A mendon Qeveria që edhe më tutje vazhdon të jetë në periferi të procesit të lobimit për njohje....?

KRYETARI: Regjia, le ta vazhdojë edhe pak.
A doni të përgjigjeni përsëri? Urdhëro!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti deputet Gashi!
Në momentin kur kemi vendosur për të shpallur Kosovën të pavarur, sovranë dhe demokratike, kemi vendosur që ky vendim historik për Kosovën të jetë vendim i koordinuar me miqtë dhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Dua ta them me përgjegjësinë më të lartë kombëtare dhe institucionale se njohja e pavarësisë së Kosovës është një rast unik të shpalljes dhe njohjeve ndërkombëtare për një shtet në historinë politike botërore të 30 vjetarit të fundit, Dhe vetëm nëse e merrni dhe krahasoni shpalljet e pavarësive të

vendeve të ndryshme të periudhës së 30 vjetarit të fundit dhe procesin e njohjes së këtyre shteteve nga bota demokratike, mund të them se Kosova është numër një rekord sa i përket njohjeve. Nuk ka qenë i lehtë i gjithë ky proces, por, lobim, dua të potencoj se kemi bërë që prej fillimit të viteve '90 e jemi duke vazhduar edhe sot. Është rezultat i gjithë asaj periudhe, i përpjekjeve, i sakrificave, diplomacisë efektive që ka qenë e para së gjithash nga viti '98. Por, nuk ka qenë e lehtë që të binden të gjithë ata njerëz, të gjitha ato shtete për njohje kaq të fuqishme dhe sot kemi edhe njohjen prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës, prej shumicës së vendeve të Bashkimit Evropian, por të gjitha vendet e Bashkimit Evropian e përkrahin pavarësinë e Kosovës. Disa vende janë në proces të respektimit të procedurave të tyre për njohje dhe kemi mirëkuptim, ndërsa nuk ka vend të Bashkimit Evropian që e refuzon njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Në anën tjetër ka ndodhur edhe njohja nga Japonia, nga Kanadaja dhe jemi duke bërë lobim, mund të them efektiv, për njohje edhe në procesin që unë e quaj pas kësaj njohjes kualitative numerik që unë besoj që do të jetë më i lehtë dhe Kosova, gradualisht, po kalon në fazën e integritit. Dje, si Qeveri e Kosovës edhe e kemi prezantuar programin për integrim në Bashkimin Evropian, në procesin e Bashkimit Evropian, por edhe në NATO. Prandaj, ne kemi kaluar procesin e vështirë të njohjeve të fuqishme, tash duhet të mendojmë paralelisht njohjen e pavarësisë nga vendet që kanë mbetur për ta njohur, por edhe procesin e integritit në NATO dhe në Bashkim Evropian.

E di se Beogradi i numëron vendet, sepse ka vende më tepër që nuk e kanë njohur pavarësinë, por, gjithmonë, duhet të mendojmë kush e ka njohur pavarësinë e Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!

A keni pyetje shtesë, zoti Gashi?

E ka fjalën deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Jo, nuk kam pyetje shtesë, konkretisht, por e falënderoj Kryeministrin për elaborimin e procesit të lobimit për pavarësinë e Kosovës, natyrisht, diçka që të gjithë kemi qenë dëshmitarë të kësaj. Vetëm diçka, sa i përket njohjes kualitative, Qeveria ka mundësi të thotë atë që thotë, ndërkaq sa i përket njohjes kuantitative ne kemi pasur një premtim se brenda 100 – ditëve do të kemi 100 shtetet e para që do ta njohin Qeverinë e Kosovës Pra, këtu konsiston pyetja ime -a është bërë mjaft në këtë drejtim?

KRYETARI: Faleminderit, por ende nuk janë bërë 100 ditë. Duhet të presim.

Pyetja e pestë- deputetja Donika Kadaj – AAK, pyetje për Kryeministrin, zoti Thaçi.

Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj për ta parashtruar pyetjen? Regjia.

A e ke prekur pullën elektronike?

DONIKA KADAJ: Faleminderit! Deputetët e rinj mund të bëjnë edhe gafe të tilla.

Pyetja për Kryeministrin, zotin Thaçi është- Në momentin më të ndjeshëm për vendin, kur pritej të bëhej shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe njohja e saj. ju keni drejtuar gishtin ndaj 7500 punëtorëve të KEK-ut, duke i quajtur “sabotues” edhe pse e keni ditur

që problemet me energji elektrike ekzistojnë tash e 8 vjet dhe janë trashëguar nga e kaluara kur KEK-u është eksploatuar pamëshirshëm nga okupuesit. Në këtë mënyrë ju keni përgjithësuar fajin e paragjykuar dhe keni thyer punëtorët të cilët në kushte shumë të rënda punojnë me paga shumë të ulëta, ua përkujtoj dhe japin kontributin e tyre që Kosova të ketë energji elektrike.

Pyetja ime është- Cilat veprime i ka marrë Qeveria e Kosovës, në mënyrë që të zbulohen “sabotuesit” e shpallur nga ju?

KRYETARI: Kryeministër e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Më parë i mbeta borxh në përgjigjen shtesë ndaj deputetit Gashi. Dua t’ju falënderoj edhe juve personalisht, por edhe si parti për lobimin që e keni zhvilluar, ndërsa kur është përmendur numri 100 i vendeve për njohje, nuk është përmendur 100 ditshi i Qeverisë, se njohja e pavarësisë së Kosovës nuk ka të bëjë vetëm me Qeverinë, por me të gjithë ne, gjithë kontributin e gjithë neve që jemi këtu në Parlament dhe jashtë Parlamentit, me punën e suksesin. Pra, menaxhimi i gjithë asaj situate në mënyrë të shkëlqyeshme nga të gjithë ne, i ka hapur perspektivë njohjes më të fuqishme dhe më numerike.

Në anën tjetër dua të potencoj se tash me nxjerrjen e Kushtetutës së shtetit të pavarur sovran dhe demokratik të Kosovës do të ketë fuqizim të njohjes.

E nderuara deputete, Donika Kada- Bujupi,

E para, unë gjithmonë kam shprehur shqetësimin për gjendjen e rëndë të punëtorëve në KEK dhe gjithmonë jam përkushtuar dhe sot jam duke punuar për ngritjen e pagave të punëtorëve të KEK-ut që assesit të mos mbesin në atë gjendje përbuzëse që kanë qenë në 8 vjetët e kaluara. Që në mbledhjen e parë, prandaj ajo që ju e potenconi se Qeveria ka theksuar e potenconi ju dhe është opinionin juaj, por përulem para çdo punëtori të KEK-ut që punon aty, dhe kemi rritur përkushtimet të përkujdesjes institucione të tyre. Prandaj, edhe ju ftoj që mos t’i fyeni punëtorët që janë duke punuar maksimalisht me gjithë energjinë dhe fuqinë e tyre.

Që në mbledhjen e parë të Qeverisë kam kërkuar nga ministrat që të jenë aktiv dhe të fokusuar në këto punë. Prandaj, dua të potencoj se kemi pasur qëndrimet tona shumë të qarta, qëndrimet të cilat i kemi prezantuar publikisht. E kemi theksuar se ka pasur dhe ka keqmenaxhim, se ka pasur dhe ka keqpërdorim, i kemi dhënë mbështetje të plotë organeve të drejtësisë të kryejnë punën e tyre, prandaj përgjigjen në pyetjen tuaj do ta merrni nga organet e drejtësisë, duke mos ndikuar autoritetet e Qeverisë.

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër.

Deputete, a ke pyetje shtesë?

KRYETARI: Deputetja, Donika Kada- Bujupi

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Kryeministër edhe një herë ua përkujtoj se ju keni qenë ai që i keni quajtur “sabotues” dhe nuk e kam bërë unë atë fyerje, por ju. Dhe e dyta, në cilat vende demokratike, kryeministri i vendit i zbulon “sabotuesit” ? Ju faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër!

Unë si kryeministër i vendit, jam i zotuar dhe do të vazhdoj të punoj maksimalisht për pengimin dhe luftimin e dukurive negative dhe e kam obligim kushtetues, por edhe qytetar edhe moral, po, para se gjithash kushtetues. Prandaj, nuk dua t’i përzini 7500 punëtorë, që bëjnë punë të mrekullueshme me ata të cilët e kanë mbajtur Kosovën në terr në tetë vjetët e fundit, të cilët ju, personalisht, i njihni shumë mirë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Përsëri pyetja e gjashtë nga deputetja, Donika Kadaj.

Pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi. Zonja deputete e keni fjalën.

DONIKA KADAJ: Ju faleminderit, kryetar.

I nderuar Kryeministër,

Keni ardhur në pushtet me bajrakun për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës, një segment, në të cilin jeni fokusuar shumë, sidomos, gjatë fushatës elektorale, ka qenë edhe energjia elektrike.

Pas marrjes së pushtetit, përveç disa deklaratave mediale, nuk po shihet ndonjë përmirësim. Kohë më parë keni shpallur krizë nacionale energjetike dhe keni emëruar një grup që të merret me këtë çështje. Prandaj, pyetja ime është- Cilat janë veprimet konkrete të Qeverisë për këtë çështje dhe kur, do të thotë, kur, një afat kohor, do të kemi dalje nga kriza e shpallur nga ju?

KRYETARI: Kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Besoj se kësaj radhe pyetja nuk është si zëdhënëse e KEK-ut, por është si deputete, kështu që.. Është e vërtetë se kemi hartuar strategjinë për nxjerrjen e Kosovës nga kolapsi energjetik. Është e vërtetë se kemi premtuar gjëra edhe gjatë procesit elektoral, por asgjë s’ kemi premtuar sa jemi duke punuar sot për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës dhe reformat demokratike si Qeveri e Kosovës, dhe është një vlerësim i lartë për punën e Qeverisë që po bën. Prandaj, kjo strategji që kemi nxjerr si Qeveri e Kosovës, do të jetë një strategji që të kemi furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike brenda 9 deri në 12 muaj.

Kjo strategji do të rezultojë me një rrjet të privatizuar të rrjetit të distribucionit, prodhim vendor të energjisë elektrike më të mirë dhe një praktikë e vendosur e partneritetit privat, publik në sektorin e energjetikës. Kompanitë do ta udhëheqin prodhimin dhe

distribucionin si biznes efikas me motiv profiti, duke e përfituar vendi dhe qytetarët e Kosovës.

Strategjia do të ndihmoj, për herë të parë të kthejë rrjedhën e fondeve nga buxheti në sektorin energjetik, kështu që paratë, mjetet do të rrjedhin në drejtim të kundërt, nga sektori energjetik në buxhetin e Kosovës.

Furnizimi i vazhdueshëm me energji elektrike, do të ndihmojë, në bazë të kësaj strategjie zhvillimin e sektorit privat, duke pasur ndikim pozitiv në zvogëlimin e papunësisë. E ritheksoj përsëri, aktivitetet afatshkurtra që përfshinë privatizimin dhe konsesionimin në sektorin e energjetikës, do të ndihmojnë përmirësimin e klimës investuese për zhvillimin e kujdesshëm të projektit “Kosova C”.

Pjesëmarrja e kapitalit privat dhe ekspertiza e gjeneratës ekzistuese në Kosovë, si dhe operacionet në miniera, gjithashtu, do të ndihmojnë në avancimin e performancave ambientale, do t'i zvogëlojnë detyrimet sociale dhe ambientale dhe do të sigurojnë në dislokim të lehtë të pajimeve ndotëse.

Qeveria, do të vazhdojë të kërkojë strategji dhe alternativa për energji alternative nga: uji, era, dielli dhe gazi natyror, që të diversifikojë burimet e energjisë për një zhvillim më të qëndrueshëm të sektorit.

Qeveria e Kosovës, do të jetë e aftë të përkushtohet në zhvillimin e rrjetit transmetues, përqes, sipas obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Athinës për energji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Kryeministër!

Deputete a ke pyetje shtesë? Po, Donika Kadaj ka pyetje shtesë.

DONIKA KADAJ: I nderuar Kryeministër, ju faleminderit, por kjo më tepër është një strategji afatgjate. Pyetja ime konkrete është- Kur do të kemi rrymë, sepse deri sot, përveç që e keni ngritur çmimin e energjisë elektrike, e keni përkrahur rritjen e tarifave, nuk po shohim ndonjë rezultat konkret që jeni duke bërë, se kur do të kemi energji elektrike dhe rrymën po e shohim, në fakt, dritat po i shohim vetëm në automjete, në ligjin 24 orë, që duhet të jenë. Përndryshe, nuk ka rrymë Kryeministër dhe kur do të ketë rrymë, sepse ke ardhur me bajrak në dorë që do ta përmirësosh furnizimin me energji elektrike?

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI- Zonja, zonjushë deputete. Ju e dini se këtë pyetje që ju e parashtroni sot, këtu në Kuvendin e Kosovës, juve dhe partisë suaj ua kanë parashtruar qytetarët e Kosovës tetë vjet, kur Kosova do të dalë në dritë? Prandaj, atë gjendje të rëndë që e kemi gjetur për tetë vjetët e kaluara, ka qenë vështirë të tejkalohet për 3 muaj, por kjo është një strategji e sigurt që e nxjerr Kosovën nga kriza energjetike

dhe fillimin e procesit të mbarë. Pra, nga mentaliteti i emergjencës në punë konkrete për të mirën e vendit dhe të qytetarëve.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Kryeministër!
Pyetja e shtatë, përsëri deputetja Donika Kadaj, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi. Unë e kisha pasur një kërkesë, që deputetët të jenë deputetë dhe të mos jenë zëdhënës, të mos i vazhdojnë profesionet e zëdhënësve edhe në Parlament.
Deputete e keni fjalën. Urdhëro, mund ta parashtroni pyetjen.

DONIKA KADAJ: I nderuari kryetar, lexoni Rregulloren dhe mos komento, pyetja është për kryeministrin.
Në vazhden e deklaratave për një Qeveri funksionale, ju publikisht deklaruat se në Qeverinë tuaj nuk do të ketë ministra që do t'i mbajnë dy poste njëkohësisht. Ndërkohë, pothuajse, dy muaj pas kësaj deklarate, ministrat e Kabinetit tuaj vazhdojnë të punojnë, të ligjërojnë dhe të mbajnë poste shtesë nëpër institucionet tjera, në UP dhe në institucionet tjera private.
Pyetja ime është - Pse nuk i keni mbajtur premtimin e dhënë publikisht dhe kur do t'i kërkonit falje opinionit për këtë të pavërtetë të deklaruar?

KRYETARI: Kryeministër e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete Bujupi.
Qeveria e Kosovës e ka mbajtur dhe respektuar vendimin me përpikëri, dhe ju e dini këtë. Në mbledhjen e parë të Qeverisë kam kërkuar nga ministrat që të jenë aktivë dhe të fokusuar në punët e Qeverisë. Kemi marrë vendim në Qeveri, që ministrat të mos i kenë dy vende të punës dhe të mos jenë anëtarë të bordeve të ndërmarrjeve publike dhe të mos ushtrojnë asnjë veprimtari, e cila paraqet konflikt interesi me punën që e bëjnë. Ripërseris, veprimtari e cila paraqet konflikt interesi me punën që e bëjnë. Njëkohësisht, kam kërkuar nga ministrat, deputetët. gjithashtu, që të heqin dorë nga paga e deputetit apo e anëtarit të Qeverisë dhe të kenë vetëm një pagë. Kjo ka ndodhur, është respektuar. Ministrat më kanë thënë: "Na ke marrë në qafë"

Në këtë drejtim, kam kërkuar edhe nga zëvendëskryeministrat dhe ministrat, që të heqin dorë, përkatësisht nga zëvendëskryeministri, që të heqin dorë nga puna në universitetet private, çka edhe kanë bërë. Asnjë prej ministrave që janë këtu sot dhe që punojnë në Qeverinë e Kosovës, nuk ligjërojnë në universitetet private, prej ditës që kanë filluar punën në Qeveri.

Puna në Universitetin Publik të Prishtinës, është garantuar me ligjet në fuqi dhe nuk paraqet konflikt interesi. Këto ligje janë votuar në Kuvendin e Kosovës dhe kurdo që, ju deputetë të nderuar, ta ndryshoni ligjin, ju garantoj, unë do ta respektoj, së bashku me të gjithë anëtarët e Qeverisë.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Pyetje shtesë?

Ju faleminderit Kryeministër! Deputetja Donika Kadaj e ka fjalën.

DONIKA KADAJ: I nderuar Kryeministër,

Ne i dimë ligjet. S'e e di ju kur keni dhënë deklaratën a keni qenë i njohur me ligjin apo jo, mirëpo, fjala e dhënë publikisht e një kryeministri të vendit, duhet të mbahet. Do të thotë, nuk është fjala për ligj, por e keni dhënë një premtim publik, të cilit nuk ju jeni përmbajtur.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Kryeministër, a e dëshironi fjalën?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete, vetëm bëje dallimin ndërmjet universiteteve private dhe Universitetit Publik.

Unë kam kërkuar nga të gjithë zëvendëskryeministrat, nga ministrat, për fat të mirë edhe timin edhe të Kosovës, janë shumë profesorë të universiteteve të botës akademike, kam kërkuar që t'i përkushtohen punës vetëm në Qeveri dhe assesi të mos ketë konflikt interesi për të vazhduar punën në universitetet tjera apo punë tjera. Kjo është respektuar me përpikëri, por unë si kryeministër i Kosovës, si Qeveri e Kosovës e kam obligim ta respektoj vendimin, ligjin që është nxjerr nga Kuvendi i Kosovës. Prandaj, unë vetëm po e respektoj ligjin.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Kryeministër!

Pyetja e tetë, deputeti Sabit Rrahmani nuk është këtu. E lëmë për seancën tjetër.

Pyetja e nëntë dhe e fundit, për shkak të kohës për sot, është e deputetit Gani Geci, pyetje për Kryeministrin, zotin Thaçin.

Zoti deputet, e keni fjalën.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Edhe ne i bashkëngjitektemi dy ngjarjeve të mëdha që kanë ndodhur dje dhe gëzohemi për ato.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, neni 26, pika 2, unë parashtroj këtë pyetje. Në bazë të informacioneve që kemi nga banorët e fshatit Debelldë të komunës së Vitisë, del se disa mijëra hektarë tokë janë aneksuar nga shteti i Maqedonisë në bazë të një marrëveshje që e ka bërë Qeveria e Serbisë me Qeverinë e Maqedonisë.

Pyetja konkrete është - Sa hektarë tokë private janë aneksuar nga Qeveria e Maqedonisë dhe a janë kompensuar fshatarët prej vitit 2001, kur kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi dhe a kanë mundësi fshatarët ta punojnë tokën e tyre?

Ju faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari deputet Geci, Shteti i pavarur dhe sovran i Kosovës është shpallur në përputhje të plotë me Dokumentit e Presidentit Ahtisari dhe Deklaratën e Pavarësisë, me krenari dhe përgjegjësi, e kemi nënshkruar të gjithë.

Zoti deputet,

Institucionet e Kosovës me sukses kanë filluar së implementuari Dokumentin Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari. Ka ndodhur takimi i parë ndërmjet autoriteteve shtetërore të Kosovës dhe atyre të Maqedonisë, me ndërmjetësimin e autoriteteve civile dhe ushtarake ndërkombëtare.

Kemi takuar përfaqësuesit edhe të fshatit Debellde, të cilët do të jenë pjesë aktive e tërë këtij procesi. Vendimi përfundimtar i Kosovës, do të jetë vendim i përbashkët i të gjithë neve, vendimi për paqen, stabilitetin dhe bashkëpunimin.

KRYETARI: Ju faleminderit, Kryeministër!

A keni pyetje shtesë deputet? Fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Nëse me ligjet ndërkombëtare prona private është pronë e shenjtë, si u bë që fshatarët e fshatit Debellde nuk gëzojnë të drejtën ta shkelin pronën e tyre private të aneksuar nga Maqedonia? Komisioni që ju e keni formuar, desha të di se tokën private të fshatarëve të fshatit Debellde, tokë të cilët e trashëgojnë nga gjyshërit dhe stërgjyshërit e tyre, duke mos e llogaritur edhe 2000 hektarë tokë shtetërore që është aneksuar, a ekziston ndonjë plan, sipas qytetarëve të Vitisë dhe fshatarëve të fshatit Debellde, plani: A, B dhe C, që prona private e tyre, që e rrethon pronën shtetërore, t'i jepet shtetit të Maqedonisë?

Ju faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti deputet, këtu nuk janë duke u zhvilluar takime për të marrë apo për të dhënë, janë takime të respektimit të Dokumentit të Presidentit Ahtisari. Ju siguroj dhe garantoj se prona private është e paprekshme, ndërsa vendimi do të jetë i përbashkët i yni për gjithçka. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ju lutem ju njoftoj, përsëri po e lexoj atë që e kam lexuar në fillim të kësaj pike të rendit të ditës. Në pajtim me rregullën 26, pika 1 e Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Ju lutem, unë ta mora kohën që ti e ke pasur për pyetje, s'je përgjigjur.

Ju lutem, koha për pyetje ka mbaruar.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

Tri pikat tjetra janë për seancën e ardhshme.

Ju faleminderit!

Pika e tretë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin, Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë Projektligjin.

RAMË MANAJ: I nderuar Kryetar i Parlamentit,
Të nderuar deputetë,
Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministër dhe ministra,

Angazhimi i Qeverisë së Kosovës, në kompletimin e infrastrukturës së nevojshme ligjore për rregullimin e të gjitha fushave të jetës në Kosovë, përbën jo vetëm epiqendrën e angazhimit tonë, por njëkohësisht edhe një nga sfidat më të mëdha për institucionet e Republikës së Kosovës.

Kjo, për faktin se një mori ligjesh të aplikueshme në Kosovë, ende nuk u përgjigjen rrethanave dhe kërkesave të reja, si dhe standardeve të Bashkësisë Evropiane, ndërkaq shtrton nevojën imediate të rregullimit të këtyre raporteve shoqërore me dispozita ligjore.

Përdorimi i vulave në institucionet e Republikës së Kosovës, është një fushë e pambuluar dhe deri me tani e pa rregulluar me dispozita ligjore. Pra, arsyeja e hartimit të këtij projektligji është rregullimi me ligj i lëmit të përdorimit të vulave nga të gjitha institucionet në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i këtij projektligji janë: rregullimi dhe përcaktimi i formës dhe i përmbajtjes së vulës, procedurës për mënyrën punimit, përdorimit, ruajtjes, si dhe përgjegjësia për përdorimin e vulës në institucionet e Republikës së Kosovës.

Ky ligji, në fakt ende projektligj paraqet bazën themelore për ushtrimin e punëve të institucioneve të Republikës së Kosovës, dhe të organeve tjera, të cilat do të përdorin vulën me përmbajtjen e përcaktuar ligjore. Nuk ka dispozita ligjore ende që mbulojnë këtë fushë.

Projektligj është hartuar në përputhje me Rregulloren e punës së Qeverisë së Kosovës, nr. 01/2007. Në hartimin e tij kanë marrë pjesë zyrtarë nga institucionet e rëndësishme të përcaktuara me nenin 32 të Rregullores së përmendur.

Në hartimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë ekspertë vendorë edhe nga institucionet qendrore. Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2008, ka miratuar Projektligjin për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës, vendimi nr. 04 fraksion

11. Ligji do të përcaktojë se cilat janë organet që do të mund të përdorin vulën, kur ato organe kryejnë punë administrative? Ligji do të përcaktojë mënyrën e saktë se çka do të përfshihet në përmbajtjen e vulës dhe cilat do të jenë format e vulave? Ligji përbëhet prej 6 pjesëve, me gjithsej 31 nene.

Çështjet që i adreson Projektligji janë:

1. Përcaktimi i përgjegjësive të institucioneve dhe personave për mënyrën e pajisjes me vulë,
2. Caktimi i institucionit përgjegjës për dhënien e lejeve për pajisje me vulë,
3. Mbajtja e evidencës për leje të dhëna,
4. Siguria e institucioneve dhe qytetarëve nga çdolloj keqpërdorimit të vulës
5. Caktimi i formës dhe madhësisë së vulës,
6. Përmbajtja dhe sigurimi i barazisë së gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës,
7. Vënia e një rendi dhe rregulli në vërtetimin e akteve autentike zyrtare të institucioneve,
8. Përmbushja e standardeve ndërkombëtare si kusht për integrimin në institucionet ndërkombëtare, dhe
9. Arkivimi i të gjitha vulave të papërdorshme për shkaqe të sigurisë.

Institucionet e Republikës së Kosovës janë të obliguara t'i përgatitin vulat e tyre në afat prej 6 muajsh, sipas këtij projektligji. Ky ligj shfuqizon çdo dispozitë ligjore që rregullon këtë materie dhe hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe pas shpalljes së tij në Gazetën Zyrtare.

Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, shtrohet para jush për miratim Projektligji për vula në institucionet e Republikës së Kosovës.

Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit, zëvendëskryeministër. Radhën e kanë shefat ose kryetarët e grupeve parlamentare. Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti, Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Përshëndetje të nderuar kolegë,

Përshëndetje Kabinet qeveritar.

Zoti Kryetar, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka marrë në afatin e përcaktuar me ligj, Projektligjin për vula në institucionet e Republikës së Kosovës, dhe e kemi lexuar me kujdes.

Me memorandumin shpjegues për këtë projektligj, janë dhënë shpjegime të nevojshme, në mënyrë të qartë dhe të përkufizuara mirë. Ky projektligj ka standarde terminologjike, që u përgjigjen gjendjes post-statusore, përkatësisht Republikës së Kosovës -shtet sovran dhe i pavarur.

Projektligji ravizon qartë dallimet ndërmjet llojeve të ndryshme të vulave, duke i definuar në mënyrë precize: formën, përmbajtjen dhe dizajnin e tyre. Po ashtu, ky

projektligj i definon qartë detyrimet dhe përgjegjësitë, prej vulëpunuesit dhe deri te: përdorimi, ruajtja dhe arkivimi pas daljes nga përdorimi i vulave.

Për nga struktura, ky projektligj është i ndarë në gjashtë pjesë dhe i organizuar në 31 nene dhe me alinetë përkatëse. Duke qenë se Projektligji është punuar me përgjegjësi dhe profesionalizëm, duke qenë se Projektligji i përcakton dhe i definon qartë llojet e vulave, përdorimet dhe ruajtjen e tyre, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah dhe e voton për të shkuar në procedim të mëtutjeshëm, natyrisht, duke rezervuar të drejtën që të japim kontributin e nevojshëm në shqyrtimin e mëtutjeshëm Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar,
Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra
Deputetë të nderuar.

Projektligji për vula në institucionet e Republikës së Kosovës, i hartuar dhe i mbështetur me Vendim të Qeverisë, nga ekspertë vendorë, të angazhuar në institucionet qendrore, rregullon një fushë të caktuar dhe shumë të rëndësishme për rregullimin ligjor të vulave, që do të përdoren në institucionet e Republikës së Kosovës.

Me këtë projektligj është paraparë që të përcaktohen: forma dhe përmbajtja, procedura e punimit, e përdorimit, ruajtjes si dhe përgjegjësisë së përdorimit nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Me vulat e raja, përmbushen edhe standardet e BE-së dhe nuk cenohen parimet e përgjithshme të *acquis communautaire*. Duke marrë parasysh se deri me tani vulat e përdorura nga institucionet tona, janë nxjerrë dhe rregulluar me udhëzime administrative, ndërsa tani e tutje me këtë projektligj përcaktohet caktimi i një institucioni përgjegjës për dhënien e vulave, mbajtjen e evidencave, sigurinë nga keqpërdorimet e tjerë, siç është Ministria e Shërbimeve Publike.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, pas shqyrtimit të hollësishëm e përkrah në parim, ndërsa vërejtjet dhe sugjerimet tona, siç janë tek punimi i vulës dhe përzgjedhja e vulëpunuesit, do t'ia paraqesë Komisionit funksional.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!
Sipas radhës AKR-ja, deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Ju faleminderit, Kryetar!
Shfrytëzoj rastin që të jap edhe qëndrimet Komisionit Funksional për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, sepse jam kryetar i këtij Komisioni dhe kemi shqyrtuar këtë Projektligj.

Komisioni funksional për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media e ka shqyrtuar me 31 mars Projektligjin për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës dhe unanimisht ka konstatuar se ky projektligj në fjalë është një nga Projektligjet më të kompletuara dhe më të mira të proceduara në këtë legjislaturë të Kuvendit.

Projektligji për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës, kanë nevojë edhe për ndonjë përmirësim, të cilat ky komision duhet t'i inkorporojë pasi Projektligji të kalojë në shqyrtimin e parë. Gjithashtu, edhe Grupi Parlamentar i AKR-së, ndanë të njëjtin qëndrim me Komisionin përkatës në lidhje me Projektligjin për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës, prandaj e përkrah dhe e mbështet miratimin e këtij projektligji në parim. Vërejtjet eventuale do t'ia përcjellë Komisionit përkatës.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Fillimisht do të dëshiroja që t'i bashkëngjitëm urimit tuaj, zoti Kryetar dhe të gjithë kolegëve për lirim të zotit Ramush Haradinaj.

Unë mendoj se gradualisht edhe si Kosovë po kompletohet mozaiku i plotë i lirisë, duke shpresuar se së shpejti në Kosovë do të na kthehen edhe dy bashkëluftëtarë tjerë: Hajredin Balaj dhe Lahi Ibrahimaj. Koknsideroj se kjo është vula e vërtetë e pavarësisë së Kosovës, me fitoren e Ramush Haradinaj në Hagë, një fitore mbi të drejtën historike për Kosovën dhe për luftën e UÇK-së.

Sa i përket Ligjit për vulat në Republikën e Kosovës, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet në parim dhe vërejtjet eventuale do t'i parashtrojë në Komisionin gjegjës.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, Kryetar.

Përsëritje të nderuar deputetë dhe ju anëtarë të Qeverisë,

Në vazhden e projektligjeve që po i procedohen Kuvendit të Kosovës, tani është në radhë edhe Ligji për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, me kujdes e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe me të drejtë konsiderojmë se është, ndoshta, ndër projektligjet më të përgatitura dhe më të kompletuara që i vjen Kuvendit. Prandaj, në parim e përkrahim dhe vërejtjet tona dhe nëse do të gjejmë vërejtje të tjera, do t'i japim në Komisionin funksional.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputetja Shpresa Murati

ŠPRESA MURATI: Hvala, gposodine predsedniče!

Nacrt zakona o pečatima institucija Republike Kosova je značajan nacrt i reguliše oblast koja do sada nije bila regulisana.

Cilj ovog Predloga zakona jeste regulisanje i odredjivanje oblika i sadržaja pečata, postuaka o načinu irade, upotrebe, čuvanja kao i odgovornosti o upotrebi pečata u institucijama. Radi se zaista o jednom Predlogu zakona koji detaljno reguliše ovu oblast sa odredbama koje su kratke, jasne i precizne.

Funkcionalna Komisija neće imati puno posla prilikom razmatranja ovog Nacrta zakona i uradiće sve da dobijemo jedan Zakon sprovedljiv u praksi.

Parlamentarja Grupa “7+” u načelu podržava ovaj Predlog zakona i daće soj doprinos u Funkcionalnoj komisiji. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, Grupi Parlamentar i SLS-së, deputeti Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovani predsedniče,

Uvažene kolege poslanici,

Poštovano gospodo ministri,

Poslanički klub Samostalne liberalne stranke će u načelu podržati ovaj zakon, s tim što zadržava pravo da primedbe i sugestije da kroz funkcionalne komisije i kroz budući rad u Parlamentu. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Tani janë në radhë deputetët e paraqitur për diskutim. Në radhë është deputeti Numan Balić.

NUMAN BALIĆ: A ma dhatë fjalën, po? Ju faleminderit, atëherë!

Ju faleminderit për fjalën e dhënë!

Ja hoću da vas selamim i da kažem nekoliko važnih stvari, odnosno jednu važnu stvar koja se tiče ovog pitanja. Naravno da se ja potpuno pridružujem apsolutno podrškama vezano za ovaj zakon, i kao još jednom nastojanju u prilog stvaranja institucija Republike Kosova, sa tim što bih obratio pažnju na jednu stvar, a ona se tiče gramatike.

Ta nam je gramatika, nažalost, stalno nedostajala ovde u Parlamentu i mnogo je puta spominjano vezano za prevode na srpskohrvatski, odnosno srpski jezik u ovom slučaju.

Ovde postoji jedna disproporcija izmedju, ja ne znam kako to zakonodavci, toliki učeni ljudi nisu primjetili, izmedju tumačenja okruglog pečata i četvrtastog pečata. U zakonu piše da kod okruglog pečata treba da stoji Republika Kosovo, dok u onom članu koji

objašnjava četvrtasti pečat, kaže da treba da piše Republika Kosova, mislim na verziju na srpskohrvatskom ili srpskom jeziku.

Želim da Vas upozorim da, kao što je poznato, ove tri verzije su na sledeći način prema pravopisu koji postoji: Albanska verzija „Republika e Kosovës“, verzija na srpskom ili hrvatskom ili bosanskom je: „Republika Kosovo“ a verzija na engleskom jeziku je „Government of Kosovo“ ili „Republic of Kosovo“. Dakle, ako je u pitanju reč vezana za republiku, odnosno državu, ona se piše „Republika Kosovo“. Ako je u pitanju Vlada, onda se piše „Vlada Kosova“. Dakle, Vlada jeste Kosova, a Republika je Kosovo. Naravno, to može biti nametnuto, može biti imponovano, ali bilo koja jezička grupa, koja bude analizirala ovo pitanje, na provoj analizi će to oboriti i vratiti Parlamentu na ponovno razmatranje. Mislim da nije pametno u ovoj našoj multietničkoj državi, mislim da treba da bude sve po redu i zakonu, i treba da se to ispoštje. Molim da se ova navedena ispravka uradi! Hvala ljepa!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla. Kisha lutur deputetët që nuk janë brenda, të kthehen për votim.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Projektligji për vula në institucionet e Republikës së Kosovës ka rëndësi sepse e vë kornizën ligjore, me të cilën vula vihet nën autoritetin dhe sovranitetin e shtetit të Kosovës. Prandaj, qëllimi këtu është që të sigurohet përdorimi adekuat i vulës së bërë nga shteti dhe të ndihmojë obligimet që dalin nga Kushtetuta. Me fjalë të tjera, përdorimi i saj duhet të bëhet vetëm për qëllime zyrtare.

Me këtë Projektligj janë caktuar përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës dhe të zyrtarëve për mënyrën e pajisjes, të përdorimit, dhënien e lejes, mënyrën e ruajtjes, formën dhe madhësinë e vulës, mbajtjen e evidencës, arkivimin dhe përdorimin e gjuhës zyrtare. Po ashtu, Projektligji parasheh parandalimin dhe keqpërdorimin e vulës si dhe ndëshkimet me gjoba.

Projektligji është në pajtim me parimet e legjislacionit evropian. Megjithatë, nuk e kam parë deklaratën financiare dhe dëshiroj ta pyes zëvendëskryeminstriin se sa është kostoja e këtij Ligji? Sa u përket vërejtjeve, vërejtja ime është se Projektligji duhet plotësuar me një nen me të cilin ndalohet përdorimi i vulës në fushatat zgjedhore për të ndihmuar zgjedhjen e kandidatit.

Në parim e mbështes, megjithatë kërkoj nga zëvendëskryeministri të tregojë koston e këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti, Enis Kervan

ENIS KERVAN: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Natyrisht që Projektligji ka formën dhe strukturën standarde. E kam një vërejtje, të them, gjuhësore apo teknike. Neni 6.3, duhet patjetër të ketë një harmonizim

ndërmjet versioneve gjuhësore, sepse në gjuhën shqipe e nënkufizon me institucione komunale, kurse në gjuhën serbe dhe angleze ka një kuptim tjetër. Neni 6.3 thotë: “Teksti i vulës së institucioneve komunale”, në gjuhën shqipe, kurse në gjuhën serbe thotë :”Tekst pečata institucije“, njësoj edhe në gjuhën angleze: “Tekst of institucions”. Ky gabim gjuhësor është i rëndësishëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Pasi nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur për diskutim, e vë në Projektligjin në votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Në sallë janë 76 deputetë. “Për” kanë votuar 70, 1 është “kundër”, asnjë abstenim.

Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për përdorimin e vulave në institucionet e Republikës së Kosovës.

Në bazë të Rregullës 23.7 dhe 35.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media,
2. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
4. Komisionin për Komunitete dhe
5. Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin Raportin me rekomandime.

Para se të fillojmë shqyrtimin e pikës së 4-të të rendit të ditës, një pauzë prej 20 minutash.

Vazhdimi i punës së seancës pas pauze
Mbledhjen e drejtoi zoti Naim Maloku

KRYESUESI NAIM MALOKU: Të nderuar deputetë dhe ministra, po vazhdojmë punën. Në radhë është pika e katërt e rendit të ditës.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë private

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: I nderuar, zoti kryesues,
Të nderuar ministra dhe deputetë,

Më lejoni ta prezantoj para jush Projektligjin për sigurinë private, të iniciuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.

Me qëllim të krijimit të kornizës ligjore për ushtrimin e veprimtarisë së sigurisë private nga subjektet afariste dhe personat të cilët ushtrojnë veprimtarinë, format dhe kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së sigurisë private të njerëzve dhe të pasurisë e që nuk janë në fushën e përgjegjësisë dhe të autorizimeve të organeve shtetërore, Ministria e Punëve të Brendshme ka iniciuar Projektligjin për sigurinë private.

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është vendosja e rregullave ligjore lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së sigurisë private nga ana e kompanive të sigurimit.

Projektligji i adreson çështjet që kanë të bëjnë me:

- subjektet që merren me ushtrimin e veprimtarisë për sigurinë private;
- format e ushtrimit të sigurisë private,
- dhënien e marrjen e licencave, dhe
- mbajtjen e evidencave të subjekteve që merren me ushtrimin e veprimtarisë së sigurisë private dhe kushtet për mbikëqyrjen dhe zbatimin e tij.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është e një rëndësie të madhe për faktin se bën rregullimin ligjor për ushtrimin e veprimtarisë së sigurisë private si dhe përcakton kushtet për të ushtruar këtë veprimtari nga subjektet afariste dhe personat.

Projektligji ka 9 kapituj, me gjithsej 63 nene dhe nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, gjegjësisht me parimet bazë të Acquis Communautaire.

Projektligji nuk përmban elemente diskriminuese dhe krijon stabilitet legjislativ për fushën që e rregullon.

Për zbatimin e këtij projektligji nevojiten mjete buxhetore, por edhe krijohen të hyra për buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Projektligji është i përgatitur në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në bazë të arsyeve të lartcekura, propozoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës Projektligjin për sigurinë private ta miratojë, në parim. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Pas prezantimit të këtij projektligji, hap debatin për diskutim, në parim.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 66 deputetë dhe janë plotësuar kushtet për të debatuar, në parim, për këtë projektligji.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë dhe të pranishëm,

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka trajtuar Projektligjin për sigurinë private dhe e mbështet Projektligjin, në parim.

Më lejoni t'ju them se kjo fushë në Kosovë, deri më tani është mbuluar juridikisht me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/33, ndërsa në praktikë është zbatuar nga një numër i shoqërisë që merren me siguri private.

Në vendin tonë është në rritje nevoja për siguri private krahas zhvillimit të bizneseve dhe rritja e pasurive dhe personave që kanë nevojë për siguri private.

Nga ana tjetër, gjatë viteve që i lamë pas, janë vërejtur shumë zbrazësi ligjore në këtë fushë që, në një masë, ndoshta, kanë ndikuar që ofruesit e shërbimeve në Kosovë të mos veprojnë krejtësisht njësoj si dhe të mos afrojnë gjithëherë shërbime adekuate. Prandaj, ky projektligj është shumë i nevojshëm dhe i plotëson kërkesat për shërbim cilësor dhe efikas nga një personel i përgatitur dhe kredibël.

Gjithashtu, Projektligji plotëson kërkesat e arsyeshme që kanë pasur deri më tani kompanitë e sigurimit privat, të cilat nuk janë të rregulluara me ligj, siç është çështja e shkallës së mbrojtjes dhe intervenimit proporcional, mënyra e mbajtjes dhe rastet e përdorimit të forcës dhe të armës në shërbim.

Ligji ka filluar të punohet shumë më herët dhe do të aprovohet në lexim të dytë, pas aprovimit të Kushtetutës.

Duke pasur parasysh se vendi është pavarësuar, edhe këtij projektligji, sikur ligjeve të tjera, duhet t'u hiqet pasusi i parë - në faqen e parë, ku flitet për "bazueshmërinë kushtetuese të nxjerrjes së këtij ligji", sepse ligji nuk është më i bazuar në Kornizën kushtetuese, por do të jetë i bazuar në Kushtetutën e Kosovës.

Gjithashtu, ka nevojë që, gjatë procedimit në komisione, të rishikohen nenet 12 dhe 43, ku flasin për përvojën pesëvjeçare të punës në lëmin, siç thuhet "lëmin relevant" që kërkohet nga udhëheqësit dhe kompanitë e sigurimeve për të siguruar licencën dhe punën. E para, nuk është precizuar se çka nënkuptohet këtu "taksativisht" dhe tutje "të nevojshme" me shprehjen "lëmë relevante". Por, edhe sikur të ishte përcaktuar kjo, kushti i përvojës pesëvjeçare së paku për një periudë ndoshta edhe dhjetëvjeçare, në këtë rast, edhe kërkesat për përvojë shumë të gjatë pune dhe por edhe sot në Kosovë, shpesh përdoren për konkurrencë jolojale, pra për t'i rrëzuar konkurrentët në formë jo të drejtë.

Në kohën kur ne jemi në fillim të ndërtimit të institucioneve të mirëfillta, thirrja në këto lloj kohësh të gjata, nuk ka ndonjë kuptim.

Grupi ynë Parlamentar në procedimin e mëtutjeshëm do të japë kontributin e vet për t'u bërë ligji sa më i përsosur, ndërsa në lexim të parë do ta votojmë dhe ju thërrasim që ta votoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, shefi i Grupit Parlamentar, deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministër dhe ministra,

Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet në parim Draftligjin e paraqitur nga ministri Pajaziti.

Pa dashur të hyjmë në detaje, arsyet u thanë e u paraqitën dhe ne do të japim kontributin tonë në leximin dhe shqyrtimin që do të bëhet përmes komisioneve funksionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, e ka fjalën deputeti Shkumbin Demalijaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra dhe zëvendëskryeministër të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht, edhe mua më mbetet të përshëndes kthimin triumfues të zotit Haradinaj nga Tribunali i Hagës, duke ndier keqardhje për zotin Lahi Brahimaj, por besojmë se në procedurat e mëtutjeshme edhe ai do të vijë dhe kthehet në vendin e tij të punës.

Sa i përket Projektligjit, në këtë rast, ne si Grup Parlamentar e mbështesim në parim, me gjithë vërejtjet e mëhershme që u dhanë, mirëpo edhe me vërejtjet që do të pasojnë nga deputetët e tjerë. Mendojmë se vlen të kalojë në parim për shkak se duhet plotësuar kërkesat e nevojshme të qytetarëve dhe të kompanive që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës për të njëjtën çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Më lejoni, të nderuar deputetë, që të kufizohem nga roli i kryesuesit të seancës dhe të jap vlerësimet dhe sugjerimet në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së në lidhje me Ligjin për të cilin po debatojmë në parim.

NAIM MALOKU: Të nderuar deputetë,

Ministra të pranishëm,

Para nesh është Ligji për sigurinë private që shtjellon dhe vë brenda kornizave ligjore një veprimtari jashtëzakonisht të rëndësishme dhe të ndjeshme.

Zakonisht, në shtetet demokratike të Bashkësisë Ekonomike Evropiane, numri i pjesëtarëve të kompanive të sigurimeve private tejkalon numrin e pjesëtarëve të policive

të atyre shteteve. Ne nuk e dimë përafërsisht sa është numri i pjesëtarëve të një morie kompanish të sigurimeve private në Kosovë, që kanë fituar licencat nga administrata e UNMIK-ut dhe që kryejnë veprimtarinë e sigurisë private në Kosovë.

Në disa shtete kjo veprimtari quhet “Industria private e sigurisë”, në disa të tjera “Kompanitë private të sigurisë”. Ligji në fjalë ka të bëjë me sigurinë private në Kosovë dhe gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në komisionet funksionale dhe përkatëse do të debatohet edhe për emërtimin e kësaj veprimtarie.

Iniciativa për hartimin e këtij projektligji është marrë në Komisionin parlamentar për siguri, në mandatin e kaluar. Ju këtu nuk e keni listën e Grupit që e ka hartuar këtë projektligj dhe besoj se Ministria do t’ia procedojë Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri.

Ky projektligj do të rregullojë gjithë veprimtarinë, pra prej licencimit të kompanive private të sigurisë, licencimit të personelit, aftësimit të të gjithë pjesëtarëve që do të jenë të punësuar në kompani të sigurimeve dhe shumë gjëra të tjera që kanë të bëjnë prej uniformës, lejes së bartjes së armëve, në cilat raste dhe në cilat licenca. Pra, është një ligj i cili, sipas mendimit tonë, është i domosdoshëm për Kosovën dhe rregullimin e kësaj veprimtarie.

Më lejoni që, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, të jap mbështetjen në parim për këtë projektligj dhe, pasi jam edhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri, lus të gjitha grupet parlamentare të Kuvendit që t’i kushtojnë vëmendje të veçantë shqyrtimit të këtij projektligji dhe me kohë të parashtrojnë amendamentet e tyre të mundshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-ës, e ka fjalën deputeti Gani Geci.

GANI GECI: I nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë, ministra,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar Projektligjin për sigurinë private dhe duke pasur parasysh nevojat për rregullimin e punëve për subjektet afariste në lëminë e sigurisë private dhe duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të punëtorëve që punojnë në këtë lëmi, Lidhja Demokratike e Dardanisë – Grupi Parlamentar e mbështet në parim këtë projektligj i cili rregullon licencat, masat, autorizimet, detyrimet, organizimin, mbikëqyrjen, evidencën dhe dispozitat tjera.

Vërejtjet tona, eventuale, do t’i adresojmë gjatë amendamentimit të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputetja Mufera Shinik.

Faliminderit. Sayın Başkan, Bakanlar ve Milletvekilleri

Özel Güvenlik Yasa Tasarısı, özel güvenlik konusunda öngörülen işlerin gerçekleşmesi alanında ve izin verme şeklinde önem taşımaktadır. Bu Yasa Tasarısının birinci okunuşunu 7+ Parlamenter Gurubu olarak kabul etmekteyiz. Gerekli tamamlamaları Fonksiyonel Komisyonuna sunduğumuzda gözönünde bulundurulmasını arz ediyoruz. Teşekkür ederim. Faliminderit.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, deputeti Bojan Stojanoviq.

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovano gospodo,
U ime Poslaničkog kluba Samostalne Liberalne Stranke, obaveštavam vas da mi u načelu podržavamo ovaj zakon zato što smatramo da je potrebno da se uredi oblast koji ovaj zakon tretira i obuhvata.

Ostale sugestije i primedbe ćemo dati kroz funkcionalne komisije i smatram da nema potrebe ovde, ovom prilikom razmatranja Nacrta zakona, da suviše polemishemo o tome.

Još jedna stvar. Ja bih zamolio da bude prevoda, zato što, kada je gospodja Mufera malopre imala izlaganje, nije bio prevod na srpskom jeziku. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!
Tani e kanë radhën për debat deputetët.

Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi dhe të bëhet gati deputeti Riza Smaka.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!
Përshëndetje zotëri deputetë dhe zotëri qeveritar,
I bashkohem qëndrimit të Grupit Parlamentar të AKR-ës që në parim ta mbështet këtë ligj, i cili ka qenë mase i nevojshëm për rrethanat e Kosovës, aq më tepër kur industria e sigurisë private është në zhvillim e sipër në gjithë botën.

Unë kam disa vërejtje konkrete, të cilat sigurisht do t'i artikulojë edhe në formë të amendamenteve me rastin e leximit të dytë, por vetëm po i përmend këtu.

Neni 11, ku parashihen kushtet për poseduesin e licencës së siguresit, domethënë për sigurim privat. Mendoj se duhet zgjeruar listën e kushteve sepse aty kemi vetëm dy kushte, të cilat nuk nënkuptojnë krejt përgatitjet që duhet t'i ketë ai person ose ajo. Bëhet fjalë për kushtet themelore “të ketë zotësi të plotë për të vepruar dhe të mos ketë qenë i dënuar”. Në ndërkohë, ne jemi dëshmitarë që bartësit e kompanive private kudo në Evropën Juglindore, të shumtën e rasteve, janë njerëz me një të kaluar të dyshimtë dhe ndoshta nuk do të ishte keq që ta kemi një dispozitë që e rishikon pak formën që anglisht i thonë “vetting”. Pra në njëfarë mënyre të verifikojë të kaluarën e atyre njerëzve që merren me sigurinë private.

Po ashtu, neni 30, pika 6, iu mundëson punëtorëve të sigurimit privat të përdorin forcën dhe thotë: “nëse në mënyrë tjetër nuk mund të ndalojnë personin për të hyrë apo dalë nga rajoni i siguruar”. Përdorimi i forcës është mirë të zëvendësohet me një masë tjetër, sepse kjo i lë mundësi që të ketë edhe tejkalim të përdorimit të kësaj kompetence dhe, ndoshta, do të duhej këtë zëvendësuar me “përdorim të masave të domosdoshme” për të lënë hapësirë më të madhe për interpretim.

Dhe, dispozita përfundimtare, neni 57, e prolongon për 12 muaj nxjerrjen e akteve nënligjore nga ky ligj dhe kur i shtohet kësaj se, kompanive ekzistuese iu mundësohet që të operojnë edhe 24 muaj pas aprovimit të këtij ligji, është një periudhë e tejzgjatur që i lë të funksionojnë kompanitë ekzistuese, që do të thotë se është prolongim, përkatësisht stërzgjatje e tepruar e aplikimit të këtij ligji, aq të domosdoshëm për Kosovën.

Kjo do të ishte ndoshta e tëra që do të artikulohej në formë të amendamenteve, me rastin e leximit të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju Faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues! Të nderuar ministra, kolegë të respektuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Fillimisht do të kisha propozuar që, në të ardhmen, me qëllimin më të mirë të bëhen kursime edhe në këtë fushë, që kjo pjesa e parë që po i bie se i ka afër 20-30 faqe, mos t’iu dërgohet deputetëve fare, por në referenca ose në fusnota shkurtimisht, sepse edhe ashtu ajo tematikë po referohet dhe duhet të referohet nga sponzoruesi i ligjit. Domethënë, in pakti financiar, arsyeshmëria, novitetet, nevoja e tjera, e tjera.

Ndryshe, meqë jemi 120 vetë dhe për një ligj, me mija faqe do të kurseheshin dhe vlerësoj se janë të panevojshme, sepse mund të jepen në mënyrë të shkurtuar me fusnota ose referenca.

Do të kisha dhënë disa vërejtje konkrete, natyrisht duke e mbështetur dhe përkrahur këtë projektligj si të nevojshëm.

Preambula e këtij projektligji nuk është korresponente me dispozitën përfundimtare. Prandaj, duhet medoemos të harmonizohet, sepse ndryshe do të ishte kundërthënëse.

Te neni 1, kurdoherë edhe këtu pra, të mos thuhet “ky ligj”, por në fillim të thuhet “Ligji për sigurinë private (tutje: Ligji)”.

Në paragrafin 2, neni 1, thuhet “trupave shtetërore” ndër të tjera. Është shprehje që nuk përkon dhe është e rëndë. Do të duhej të jetë “autoriteteve shtetërore”. Kudo që mungon “Republika e Kosovës” në tekst të thuhet “Republika e Kosovës”, kur është në pyetje shteti.

Në nenin 3, mendoj se nuk është juridikisht i hartuar si duhet, sepse nuk bën “x1, i” e tjera. Shkenca për bërjen e ligjeve i ka rregullat e veta që janë shumë të përshtatshme edhe për atë që nuk është jurist. Bie fjala “paragrafi, alineja, pika” e jo “v3, ei, ix, x, xi” e tjera që nuk përkojnë me praktikën bashkëkohore të onomoteknikës.

Edhe këtu, kur thuhet “papakshmeri” duhet të thuhet, ju lutem, “pacenueshmeri”. Tjetër është papakshmeria, tjetër pacenueshmeria, kurse në dy gjuhët tjera, është thënë mirë. Një gabim, të them material. Te neni 3, paragrafi 1 – “shoqëri tregtare”. Në serbisht e boshjankisht thotë “udruženja”, këto janë “trgovačka društva”. Edhe në anglisht është gabimisht “association”. Këto nuk janë shoqata por janë shoqëri dhe se është dallim substancial ndërmjet shoqërive dhe shoqatave. Pra, këto janë shoqëri, nuk janë shoqata.

Në Ligj nuk praktikohet asnjëherë dhe askund që të jepen akronime. Bie fjala “KEIME”, gjithmonë titulli jepet i plotë dhe duhet të jepet edhe në këtë rast.

Neni 8, paragrafi 2, thotë ndër të tjera “dorëzohet pranë Ministrisë”. “Pranë” mund të jetë edhe aty pranë, domethënë anash, afër, prapa e tjera. “Dorëzohet në Ministri” duhet të jetë, ju lutem! Kudo që është fjala “parapara, parashikuara”. Ligji as nuk parasheh, por përcakton. Bile t’ju them edhe këtë se në tekstin e Kushtetutës, që presim të miratohet, e kemi miratuar unanimisht shprehjen “përcaktohet me ligj” e jo “parashikohet me ligj” e tjera. Prandaj, do të duhej edhe këtu dhe në të gjitha rastet tjera.

Këtu, në pjesën e dytë, të paragrafit 2, neni 8, “tematikë e rregullore, duhet t’i cedohet rregullore a ministrit përkatës në mënyrë që të ketë fushë për ta rregulluar këtë në mënyrë më konkrete”. Kjo është tematikë e rregullore së aktit nënligjor.

Neni 10, ku thotë “poseduesi i licencës”, duhet të zëvendësohet me “pronari i licencuar”, sepse poseduesi është pronari ekonomik, ndërsa pronari është pronar juridik dhe ka dallime esenciale. Poseduesi mund të jetë ilegal, mund të jetë legal, prandaj mund të interpretohet në praktikë ashtu dhe kështu, prandaj do të duhej të zëvendësohej me këtë shprehje të përshtatshme për kontekstin e fjalisë.

Te “kushtet personale” – neni 11, fillon “të ketë zotësi të plotë për të vepruar”. Juridika nuk e njeh këtë shprehje. Ka zotësi vepruese, ka zotësi juridike. Pra, “të ketë zotësi vepruese” e jo “zotësi të plotë për të vepruar”. Kjo shprehje përsëritet edhe në vende të tjera.

Te neni 14, kudo thotë “të ketë zotësi”, “të ketë kualifikim” e më pastaj “nuk ka qenë i dënuar”. Duhet të zëvendësohet me shprehjen “të mos ketë qenë i dënuar”. Domethënë, në rrjedhën e kompleksit të këtyre ndalesave.

Në nenin 23, ju lutem, thuhet kështu: “Personat, nga paragrafi 1 i këtij neni, janë përgjegjës për kompensimin e dëmit që shkaktohet si pasojë e pakujdesisë së tyre”. Pakujdesia i ka tri forma, ne juristët e quajmë “kull pallata, kull palevisimo, kull palevis”, hapen çështje mandej për praktikën. Pastaj, edhe te dëmi, nuk ka kujdesi dhe pakujdesi. Dëmi kurdoherë duhet të kompensohet, sepse nuk është fjala për përgjegjësi penale apo

kundërvajtëse. Është fjala për përgjegjësi juridike civile. Dëmtuesi duhet ta kompensojë dëmin dhe ta rimbursojë. Prandaj, propozoj të fshihet “nga pakujdesia”, sepse kurdoherë do të mund të justifikoheshin apo të heshteshin rastet, po e zëmë në disfavorin e të dëmtuarit, sepse e ka bërë me pakujdesi, e tjera – e tjera, prandaj këtu s’duhet të ketë kompromis. Dëmtuesi është i përgjegjshëm ndaj të dëmtuarës. Vetëm kjo fjalë ia jep një adut apo alibi, si të them, që edhe dëmtuesi të justifikohet dhe të dilte jo i përgjegjshëm.

“iii”, po e them kështu, sepse kështu është thënë, “në mënyrë sipërfaqësore ta kontrollojë”, sepse nëse thuhet në mënyrë sipërfaqësore, unë nuk e di çfarë kontrollimi do të ishte në mënyrë sipërfaqësore dhe del si kontradiktë e kontrollimit. Është kjo e panevojshme.

Te neni 44, duhet të shtohet edhe një amendament, që t’i jepet palës në procedurë baza juridike për mbrojtje gjyqësore. Dhe termi apo fjala “vendim” i inspektorit duhet të zëvendësohet me “aktvendim”, sepse vendimin e miraton organi kolegjial, ndërsa aktvendimin organi individual dhe natyrisht se ka gabime sepse aktvendimi është nocion juridik formal që duhet ta ketë hyrjen, diapozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin juridik, ndërsa vendimi vetëm diapozitivin dhe në atë mënyrë do të cenohej e drejta elementare e palës në procedurë sikur të mbetej shprehja “vendim”.

Ju lutem, te neni 53. Juridika nuk njeh nënparagraf. Kjo përsëritet edhe në disa akte të tjera. Ka nen, ka paragraf, ka aline, ka pikë dhe jo nënparagraf.

Edhe shprehja “gjobë” është me etimologji nga një gjuhë tjetër që do të duhej të zëvendësohej përgjithmonë me “dënim prej 150-300 euro” e tjera e tjera, e jo “me gjobë, të dënohet me të holla” e tjera, e tjera.

Dhe, përfundimisht, te neni 57, “brenda 12 muajsh”. Ndoshta do ishte afat korrekt 3 muaj ditë, sepse qëllimi është që ky ligj të aplikohet në praktikë e jo një vit, si të themi, të jepet, e pastaj rregulloret, e tjera e tjera.

Sikur që e thashë në fillim, po e përsëris. Neni 63 është në kolizion me preambulën dhe duhet të harmonizohet medoemos. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Siç shihet, nevoja për këtë Projektligj për sigurinë private ka qenë më se e nevojshme, duke marrë parasysh subjektet që deri më tani kanë ushtruar këtë veprimtari apo kjo veprimtari s’ka qenë fare e kontrolluar, ku në disa raste jemi mësuar të dëgjojmë që, ndonjëherë, në mungesë të këtij ligji dhe të atyre që kanë ushtruar këtë veprimtari në forma private, kemi pasur edhe raste me përfundime tragjike. Prandaj, shihet se është më se i nevojshëm dhe ndoshta ka qenë më se e nevojshme të rregullohet edhe më herët.

Unë, çka do të fokusoj në vërejtjet, kam për dhënien e licencës dhe për ushtrimin e veprimtarisë, prandaj do të sugjeroja që të shikohet neni 11, 12, 13, 14 dhe 15 të cilët janë

të përsëritshëm, ndërsa kushtet dhe veprimtaria janë të ndryshme, prandaj nuk mund të jenë të njëjtë sikur punëtori që bën sigurimin privat, sikur ai operatori teknik.

Edhe një vërejtje tjetër. Është dashur të kufizohet veprimi i forcës dhe të gjendet këtu edhe një amendament i cili e kufizon veprimin e forcës nga ana e këtyre njerëzve që ushtrojnë këtë veprimtari. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Deputetë tjerë, të paraqitur për fjalë, nuk ka.

Në vazhdim, lus deputetët të deklarojnë për miratimin, në parim, të projektligjit. Lus regjinë dhe deputetët të bëjnë gati për votim.

Në sallë janë të pranishëm 81 deputetë. Votojmë tash:

Të nderuar deputetë, si duket dikush ka votuar për ndonjë deputet, i cili nuk është në sallë dhe kjo me Rregulloren të punës nuk lejohet.

Konstatohet se me leximin e votave, rezultati është ky:

Me 82 vota “për” dhe asnjë “kundër”, konstatohet se Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për sigurinë private.

Në bazë të rregullave 23 pikë 7 dhe 35 pikë 4, të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional dhe raportues,
2. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
3. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
4. Komisionin për Komunitete, dhe
5. Komisionin për Integrime Evropiane.

Sipas Rregullës 35 pikë 6, komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raport me rekomandime.

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës**

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 26 shkurt 2008.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet, si vijon:

- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës ka bazë juridike në Kornizën Kushtetuese;
- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës nuk i cenon të drejtat e komuniteteve;
- Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e këtij projektligji nuk përmbajnë implikime buxhetore;
- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në cilësinë e komisionit funksional dhe raportues, i rekomandon Seancës plenare që tekstin e Projektligjit, të propozuar nga Qeveria, ta miratojë pa ndryshime.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim të tekstit të projektligjit në tërësi. Votojmë tash.

Konstatohet se me 69 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës.

E bëj me dije kryetarin e Komisionit, zoti Bahri Hysenin, se nuk është lajmëruar për fjalë, prandaj nuk kam mund t’ia jap fjalën atij që nuk paraqitet për fjalë. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve**

Miratimi, në parim, i këtij projektligji është bërë më 26 shkurt 2008.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte, me rekomandime, si vijon:

- Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për kooperativat e bujqve dhe i ka propozuar Kuvendit miratimin e amendamenteve të paraqitura.
- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit kanë bazë juridike në Kornizën Kushtetuese;
- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e këtij projektligji nuk i cenon të drejtat e komuniteteve;

- Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e këtij projektligji nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Tani do të votojmë miratimin e tri amendamenteve të këtij projektligji, të rekomanduara nga komisioni funksional.

Amendamenti 1

Lus deputetë dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 76 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti numër 1.

Për fjalë është paraqitur deputeti Bahri Hyseni. E keni fjalën zoti Hyseni. Ju lus, nëse s’e kërkon fjalën, mos u paraqitni se e doni fjalën!

(Reagim)

Më falni, por deputeti Bahri Hyseni, e kërkon fjalën dhe urdhëroni, mund ta merrni fjalën.

BAHRI HYSENI: Ishte pak me rregull që, gjatë kalimit të Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës të na jepni mundësinë që së paku të lajmërohemi për fjalë, sepse është rregulla a do të lajmërohen grupet apo ne. Ishte vetëm një çështje. Ne si Komision nuk kemi pasur asgjë tjetër të ngrehim, por kemi dashur që para deputetëve të Kuvendit të Kosovës ta ngrehim çështjen: a duhet më tutje të ekzistojë si Kod i përkohshëm penal apo të hiqet fjala “i përkohshëm”. Meqë procedimi ka qenë, prapë duke u mbështetur në bazën juridike të Kornizës Kushtetuese, ne nuk kemi bërë amendament të posaçëm, por e kemi lënë mundësinë që deputetët e Kuvendit sot të deklarohen për këtë çështje.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Ju nuk ishit në temë, prandaj kjo pikë është pikë e gjashtë e rendit të ditës dhe ne i votuam amendamentet. Prandaj, besoj se njihemi ndër veti dhe e dimë kush është kryetar i Komisionit, e ju nuk e keni kërkuar fjalën dhe për atë arsye unë nuk ua dhashë. Faleminderit!

Kalojmë në amendamentin 2, nga Komisioni funksional.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 76 vota “për”, asnjë kundër dhe 4 abstenime, konstatoj se Kuvendi miratoi amendamentin numër 2.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim të tekstit të Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Fjalën e ka kërkuar Ibrahim Makolli, para se të votojmë.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Vetëm po kërkoj që të mos përsëritet ajo që ishte më herët, të respektohet Rregulla 37 pika 3, ku pas votimit të amendamenteve, teksti i Projektligjit me ndryshimet e bëra do të shqyrtohet pasi të jetë caktuar koha për debat të mëtejme, para votimit përfundimtar. Po kërkoj nga ju, zoti kryesues, që ta respektoni këtë rregull.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja – ministre Nekibe Kelmendi, e ka fjalën.

MINISTRE NEKIBE KELMENDI: Edhe ju në fillim thatë se ky projektligj ka 3 amendamente, mos është ndonjë gabim dhe po e kalojmë një amendament pa e votuar – amendamentin 3. Këtu shihet se teknikisht nuk është bërë një ndarje me amendamentin 3, kurse fillon teksti i ri sikur të jetë fjala për një amendament 3, të cilin, në fakt, e ka propozuar Komisioni për Buxhet.

(Reagim)

NEKIBE KELMENDI: Është amendament, nuk është shtesë!

(Ndërprerje e shkurtër)

KRYESUESI: Në materialin që unë e kam para veti, janë 2 amendamente, kurse në skenarin për pikën e rendit të ditës që e kam para veti, shihet se janë 3 amendamente.

(Ndërhyrje nga Sekretaria)

Mirë. Faleminderit, zonja ministre për vërejtjen që e dhatë dhe keni vërejtur se është gabim teknik. Shërbimi adekuat tani e bëri përmirësimin, prandaj është edhe amendamenti 3.

Urdhëroni, e ka fjalën Sabri Hamiti. Faleminderit!

SABRI HAMITI: Kjo ishte për sqarim! Meqë u sqarua saktë, sepse edhe teknikisht shihet se është një amendament, bile që është propozuar nga Komisioni për Buxhet, në mbështetje të komisionit funksional, u sqarua puna. Kalojmë në votimin e tij! Kaq.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Faleminderit, zonja ministre!

Pra, vazhdojmë më tutje.

Amendamenti 3, nga Komisioni për Buxhet, në mbështetje të komisionit funksional. Votojmë tash:

Konstatohet se me 76 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti numër 3.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim të tekstit të Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash:

Konstatohet se me 78 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve.

Të nderuar deputetë, ishte kjo pika e fundit e rendit të ditës dhe me kaq po e përfundojmë seancën e sotme.

Mirupafshim në seancat e ardhshme. Faleminderit!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës